



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

**Nga procesverbali i mbledhjes së 33-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit
mbajtur më 27. 09. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰**

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Lulzim Rrustemi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
4. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
5. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
6. Rasim Hasani, Drejtor i DA
7. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
8. Ilir Tasholli, Drejtor, PU
9. Visar Kozhani, Zyrtar i lart i DBF-së
10. Burim Rustemi, Shef i kabinetit
11. Vlora Krasniqi, shefe e zyrës ligjore
12. Behar Krasniqi zyra ligjore
13. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
14. Përfaqësues , "YAHR"
15. Përfaqësues të OJQ "POLIS"
16. Përfaqësuesit e mediave
17. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
18. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
19. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimin për plotësim.

Me vëretjet e Daut Azemi Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimin për plotësim të rendit të ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 për aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 32-të ,të Kuvendit
2. Propozim vendimi për aprovimin e buxhetit 2017-2019
3. Propozim Vendimi mbi miratimin e ri-destinimit dhe transferit të mjeteve buxhetore për vitin 2016
4. Informatë nga DKA mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017

Pas aprovimit të rendit të ditës Kryesuesja tha se nëse ka pyetje..

Fjalën e mori Xhevat Olluri.pyetje për anulimin e vedimit në zonën kadastrale në Konjuh,vendimi në tërësi nuk është anuluar po ka fillu m'u anuluar në menyre të pjesëshme,pytja është a janë anuluar të gjitha pjesët e asaj zone prej 20 hektarëve,cila pjesë ka mbet edhe pse?

Florent Hoxha,i kam 2-3 qështje për t'i ngritur:në rrugën "Arif Aliu" në Gadime të Ultë janë hap disa vrima nga ujësjellësi pse nuk janë riparuar dhe nuk janë kthyer në gjendjen e më parëshme,po ashtu edhe në rrugën "Iliria" nje vrimë ende nuk është riparuar, po ashtu te lagjja e "Lekiqëve" në Gadime të Ultë është dëmtuar rruga,si dhe është hiq tabela e tonotazhës. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të sanoj. Po ashtu disa ditë më parë ka vdekur punëtori i Komunes Skender Gerbeshi së bashku me djalin,kërkoj nga Kryetari dhe Kuvendi ndarjen e shumës prej 5000 eruo pasi që ka lan të shoqen dhe djalin, që ka gjendje jo të mirë finaciare,po ashtu edhe një qështje te familja e Feim Neziri i cili ka vdekur nga sëmundja e kancerit i cili ka lën gruan dhe 4 fëmij,i cili ma heret ka zhvilluar në biznes të vogël ne Lipjan në kuader të këtij biznesi është gjelltorja "Korabi" në Lipjan kërkoj nga komuna në baza ligjore të paktën dy vite të lirohet nga qiraja kjo familje.

Blerim Gashi. Vitin e kaluar kanë marr nje zotim me ministrinë e infrastrukturës për 3 rrethrotullimet te kryqi Banullë-Dobratin,kryqi Gadime,LLugaxhi,si dhe lagjja e re për Magurë dhe Shtime që kalon,si dhe rruga për në Aeroport, a'do te fillojë sivjet?

Enver Kozhani.kërkesë e banorëve të fshatit Kraishtë dhe Ribar i Madh,ku është një kthesë e madhe dhe disa fidane 3-4 metra naltësi dhe gjatësi 20 metra të cilat pengojnë, kërkoj nga drejtoria përkatëse të intervenoj mos të ketë aksidente me fatalitet?

Lulzim Rrustemi.unë kam për t'i ngritur dy qështje e para ka të bëj nga mbledhja e kaluar për një qështje që e ngriti kryetari i komunës e që ka të bëj me "Eurokosin" dhe po e shfrytëzoj rastin që të nxjerri një arsyetim për atë qështje,dhe e dyta qështje është për përdorimin e zyreve të adminsitratës.

E para në mandatin praparak para vitit 2007 ku kryetar ka qenë ,profesori Xhevat dhe kreyshef ka qenë Kryetari i tanishëm dhe atëherë Komuna e Lipjanit ka dhën në konsesion 3 prona, te "Dino",para stacionit të policisë,të gjysëm rrethi "Adem Jashari "dhe te rruga për -ambulancë që tani atë pronë e ka "Eurokosi" që e ka marr me koncesion,në atë mandat "Eruokosi".dhe për këtë unë nuk e di me cilat procedura dhe nuk e di se kuvendi i komunës ka një vendim që i ka marr pronën komunës dhe i ka dhën "Besa Komercit" Pastaj tha se kryateri përmend takstativisht një vendim tjetër të vitit 2011 dhe unë e di mirë se ky vednim ka të bëj për përcaktimin e banesave për dhënien me qira dhe formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave.pastaj tha se para këtij vendimi kuvendi ka nxjerr rregullore për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënjen me qira të banesave të njerëzve që janë në nevojë..Në vitin 2008 në qershor komuna në bazë të kontratës të nënshkruar posedon 28% të pronës që "Eurokosi" e ka marrë me konsesion.Në këtë vednim shkruan se komuna posedon 20 banesa me sipërfaqe prej 1406.7 metra katrore kjo sipërfaqe është marr në bazë të një propozim vendimi që e ka propozu kryetari Shukri Buja dhe kuvendi është kryesisht në rregull me propozimin që ka ardh.Pastaj tha se ky vendim ka hapë rrugën për shpalljen e konkursit për ndarje të banesave por konkursi nuk është shpallur asnjëherë dhe ato banesa nuk janë ndar askujt dhe komuna e ka atë pronë aty.Ky është sqarimi im.Qështja e dytë është përdorimi i zyreve të administratës dhe se komitetet e kuvendit

mbledhjet i mabjnë në sallën e bordit dhe unë si kryesues i komitetit për planifikim dhe urbanizem mbledhjet,e këtij komiteti me marëveshje me anëtarët tjerë të komitetit i kam caktuar në ora 15:00 për shkak të shumicës së anëtarëve të komitetit që janë në punë.Në ditën që e kam pas këtë mbledhje asistentja e kryetarit tha se ne ora 16:00 unë e mbylli derën dhe nuk më intereson për mbeldhje sepse nuk kam qen e njoftuar me heret,Une mendoj se asistentja nuk mund ta caktoj orarin e mbajtjes së mbeldhjeve dhe na nuk jemi të obliguar ta njoftojmë asistenten përveq që e njoftojm administratën komunale dhe shërbimin e kuvendit.

Feriz Hasani,nje gjë që më shqetëson ka të bëjë me kompanin “Mabetex” ku komuna ja ka dhënë një pronë për ndërtimin e një fabrike mirpo ajo ka filluar ndërtimin e një muri mbi prrockën e lumit, mirëpo qytetarët janë të shqetësuar me këtë qështje deshta ta di Komuna sa janë në dijeni lidhur me ndërtimin e atij muri.?

Ramiz Qiriqi.kam disa qështje e para procesverbali ose të bëhet mirë ose mos të bëhet hiq.vetëm të shënohet diskutoj filani,Kur të votojmë është mirë të shënohen kush ka votu kundër,edhe pse janë më pak kundër.E kam një vendim për heqjen e Koksit me vendim nga inspekcioni por në të nuk shkruan koha kur kanë me hiq.Kam bër dy kërkesa për drejtorin e Arsimit asnjëren smu kanë pergjegjë edhe aty në procesverbal shkruhet se shkolla e Krojmiri është e 4 ta unë kam thënë në mesin e 4 shkollave,kamë than që është mirë edhe nxënësit Shqiptar edhe Serbë të mësojnë bashkë mos të bëhet ndarje nacilone është shkruar ndryshe..Para 3 dite takova një djalë në koridor i cili kishte punu në auditim edhe tha me krenari që jam kthi ne punë u krenojke qe u kthi ne punë ,po kam qef me dit çka po ndodh me qat djalë.Te manaxherët kryetari tha po ma bëjnë me hile janë duke më shantazhu janë tu ma bo punën keq, e vertetë ish kreyatar ku njëri menaxher që po e mbikqyr asfaltimin e rrugës te na, para syve të tina punohet keq,dhe pusetat qe i ka vu ne rrugë më herët janë vu pa beton,dhe pas interevnimit ton jan hiq ato puseta,Tretuari nga 1 metër e bëjnë 1 ,80 na mbyllet rruga dy kerre nuk mujnë me kalu, e njeita gjendje e rrugës ish edhe te “Agron Gashi”,Tjetra që një vit te Lagjja e Mjekëve del një ujë në asfalt,banorët po thojnë nëse mujnë me ndal para dimrit,

Kam edhe një kërkesë për banesat që janë pronë komunale pasi që kamë shumë besim të ju kryetar dhe te pozita që mbani tani kisha pas dëshirë t'i ndajna banesat në mandatin e juve, se më herët janë nda në menyre jo të regullt.ku i njeri deshmor ka mar banesë 90 metra katror kurse tjetri 60 metra dmth njani ka dhan gjak ma shume tjetri ma pak.andja kisha kerku t'ju ndani naj skamnorve,veternëve martirëve. Besoj qe mujna me i nda në mëyre ma të regullt, kisha kerku që gjatë qeti mandati me u nda këto banesa.

Imri Ahmeti sa i përket pyetjes së kryetarit Xhevat, për parcelat komunale ajo pronë kur nuk ka mujt mu lincencu.

Sa i perket pyetjes së Florentit për gropat, vrimat që i permend nuk jam në dijeni por drejtori Heseti duhet të merret me këtë qështje,qështja e mbitonazhës në disa rrugë shumë e drejt problemin naj ka shkaktu autostrada, për të cilën po kërkohet një zgjidhje që të prodhoj nje dalje për këta kamion.

Qështja e Skender Gërbeshit dhe e familjes se Feim Nezirit mas pari i falemderoj të gjithë qytetarët edhe bizneset që kanë kontribu për familjen Gerbeshi,dhe nuk ka pas qytetarë të Lipjanit që nuk ka shpreh solidaritetin për atë familje,unë do të bisedoj me familje do ta shohim si është gjendja nëse ka nevojë ne do ta procedojmë.sa i përket

familjes nese ligji na lejon me ja fal unë jam i gatshem me bë,në kuader të suazava ligjore.

Lidhur me pytjen e Blerimit,rruga Magurë Lipjan është publiku tenderi “Trasin Grup” është kompania, që e ka marr këtë rrugë dhe sivjet do të fillon edhe rreth retullimit janë pjesë e Minisitrisë janë zgjatë procedurat unë kam bërë kërkesë disa herë kam bo preslon shpresoj që së shpejti do të fillon

Qeshtja e objektit në Koncesion jemi në proces të regjistrimit të këtyre ,jemi ne fazen ku po regjistrohet pasuria e komunës ,banesat, lokalet

Qështja e salles është e drejtë,por kur caktohet mbledhja në ora 3 duhet të mbahet në atë kohë jo të mbahet në ora 3 e 50,se ne jetojmë në Kosovë dhe punëtorët e administratës punojnë deri në ora 4 prandaj edhe komitetet është mirë me pas parasysh këtë qështje.keni të drejt lokalet e komunës t'i shfrytzoni 24 orë po është mirë 7 ditë ma herët ose së paku një ditë më heret të njoftohet për mbledhjet.

Pyetja e Feriz Hasanit shumë e drejtë personalisht kam qenë vet në vendin e ngjarjes,me drejtorin e urbanizimit inspektoriatit,e ndajmë shqetsimin e përbashkët,ka ndodh një defekt ku edhe prona është pjesë e asaj që e kemi dhënë me koncesion tash nuk janë 2 hektar por janë minus 50 ari nuk ka dalje në pjesën përpara sepse me një vendim të këtij kuvendi i është dhënë kolegjit turk “Mehmet Aki” do ta procedojmë shumë shpejt në kuvend për ta parë situatën që është atje edhe ujërat kanë ardh si pasoj e kolegjit turk.

E falënderoj Ramizin-Luanin për shumë qështje që ngriti ndihma e tij edhe shumë qytetarëve është e domosdoshme,unë kam dalë në rrugën e Luanit jemi dakordu që projektin me nis tash ndryshe,por ka telashe.nuk është problemi vetëm i menaxherav po edhe ligjet në fuqi.dhe është e pamundëshme Kryetari i Komunes m'u marr me secilën rrugë.

Një punëtorë e ka kthi gjykata,një auditorë,dhe unë e kam respektu vendimin e gjykatës.

Qeshtja e banesave shumë shpejt duhet të vie në kuvend dhe duhet të definohet kjo qështje.

Nazmi Krasniqi përmendi qështjen e pranimi në punë të drejtorit të Krojmiri duke cituar se në mandatin tonë nuk ka punuar meqë nuk ka pasur diplomë. Në vazhdim përmendi rastin e ndërrimit të vendeve të punës të 7 punëtorëve duke kërkuar nga kryetari që t'i përmbahet fjalëve që ka dhënë gjatë fushatës me që ju kryetar keni thënë se do t'i përmbaheni Zotit dhe ligjit kurse tani po e shkelni ligjin dhe për qështje politike janë larguar nga puna.

Enver Kozhani.kërkoj nga kryetari që të interevenon në rrugën e Kraishtës në kthesë ku aty është rrezik për shkak të rritjes së disa fidaneve dhe nuk ka punë një eskavator ma shumë se dy orë për hapjen e një kanali dhe heqjen e fidaneve që pastajë rruga do të bëhet e dukshme në atë kthesë.Pastaj përmendi se aty kanë ndodh dhjetëra aksidente ku i fundit ka ndodh javen e kaluar.

Lulzim Rrustemi,kam një reagim,nuk isha i kënaqur me përgjigjen e kryetrit dhe fillimisht po them se kemi përgjegjësi për fjalën publike e gjithashtu kemi përgjithsi atë që e themi para auditoriumit, kuvendit,dhe para qyterëve që na dëgjojnë.Unë nuk isha i kënaqur me përgjigjen e kryetarit sepse në mbledhjen e kaluar është thënë se “Eurokosit” i është marr prona nga kuvendi dhe i është dhënë “Besa Komercit” dhe kjo

nuk qëndron, me që pronë prej 28% që i është dhënë me koncesion "Eurokosit" është aty ku ka qenë dhe nuk ka shkuar askund.

Kjo pronë komunale ka hy në proces në vitin 2004 dhe ka përfunduar në vitin 2007-2008. Të thuhet se kuvendi ja ka marr pronën "Eurokosit" dhe i ka dhënë "Besa Komercit" kjo është pak më tepër se racionale dhe dihet se na kemi marr vendim për forimin të komisionit për ndarjen e banesave dhe ky komision nuk ka shpallur konkurs dhe nuk janë ndar këto banesa dhe janë pronë e komunës dhe Komuna mund të fillojë ndarjen e tyre, si qeshtje e dytë përmendi qeshtjen e përdorimit të sallave për mbledhje dhe na e kemi njoftu sketorin për punë të kuvendit dhe administrata e ka për obligim me caktu sallën për mbledhje e jo asistentja siq na ka thënë duhet ta lironi sallën në ora 16:00.

Vlora Limani-Hajnuni sa i perket racionalitetit, shumë racionale u kanë me marr inxhizimin edhe një herë me ndëgju prej fillimit deri në përfundim, e dyta të qeshtja e sallave, komitetet duhet të kenë parasysh se sekori i kuvendit fillon punën në ora 8:00 dhe nuk munda na me obligu me nejt çdo ditë prej orës 15:00 deri në ora 18:00 se a e din sa komitetet janë unë i thërras komitetet prej orës 13:00 dhe në ora 15:00 e përfundoj dhe nuk mund të sillemi si Zoti para shërbyesve civila na.

Imri Ahmeti, po mundohet me ruajt klimën edhe mënyrën e komunikimit por është e pamundur me i duru disa gjëra kur thuhet krejt ndryshe e interpretohen krejt ndryshe, po konstatoj edhe një herë po marr përgjithsin publike, është procedurë në kuvend prej komisionit i është marr pjesa nga "Eurokosi", që i ka taku komunës por pse nuk i është marr në mënyrë të rregullt pjesa që i ka taku por i është marr minus 129 metra më pak pse nuk ju ka marr e tër pjesa komunës, unë marr përgjithsi nëse nuk është kështu unë ju kam dhënë materialin edhe atë ditë ju jepi përsëri kështu do qoftë, ajo hysë nuk është nda askundja ka mu dhënë por është marr prej atina zotnis, ka edhe një ankesë kontrat ku është tërësisht e pa ligjëshme. duhet të jemi real, nuk jemi përfekt, por defetket mos t'prevoj me ja shit dikundja tjetër, unë nuk bërti përgjegjësi për ndërtimet pa leje që janë ndërtu mbi etazhitet, se aty vendparking nuk ka.

Qeshtja që e përmendi Nazi kur ka diplomu unë nuk kam evidenc por e di që ai mbi 20 vite ka qenë në proces të arsimit.

Të pyetja e Enverit, për prerjen e fidaneve, pse si ke pre ti që ke qen në pushtet 6 vite, Unë e di gjendjen e të gjitha rrugëve edhe të Gadimes edhe të Sllovisë edhe të Ribarit edhe Rubovcit e tjera që ka nevoj me intervenu, dhe dëshirat janë tjera dhe mundësit janë tjera. Mua po me mundon fillozofia e të menduarit se nuk është në rregull çka tu thot dikush ta paraqitni këtu në mënyrë që të provokoni kryetarin, dhe sikur ti kishe paraqit të gjitha këto që i përmenda kish me pranuar e jo vetëm për rrugën e juaj.

Me që pyetje tjera nuk pati e me propozim të kryesues u vazhdu me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës:

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 32-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes së 32-të të Kuvendit? Luani tha në fillim dy me vërejtjet lidhur me ekstratin që i bërtim tani.

Daut Azemi, unë kam një vërtetëse te ekstrakti faqe 9 pika 4 diskutimi im nuk është vendosur hiq, dhe është vendosur diskutimi i kolegës Buqës ku ajo ka diskutuar pikën tjetër, si dhe faqe 9 kam thënë që kam dy pyetje për drejtorin, nuk përcaktohet se cka kam dashtur me thënë, unë kam thënë për demtimin dhe mirëmbajtjen e tyre këtu nuk janë cekur hiq besoj që do të shiqohet dëgjimi dhe të përmirsohen vërejtjet, Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin bash me vërejtjet që u dhanë dhe, pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për Kuvendin:

Aprovoi
Ekstraktet nga procesverbalin e mbledhjes së 32-të të Kuvendit me vërejtjet
e Ramiz Qiriri dhe Daut Azemi

Shtesë: Ekstraktet.

II
Propozim venimi për aprovimin e buxhetit 2017-2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Drejtorit për buxhet dhe financa, z. Shkelzen Hajdini, bazuar në ligjin për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë si dhe Ligjit për Vetqeverisjen lokale, Kryetari i Komunës propozon projektin Vendimin për buxhetin 2017-2019 dhe projektin propozimin e buxhetit për vitet 2017-2019.

Në vazhdim përmes kinorprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi dhe projekt buxheti për vitet 2017-2019 si dhe ndryshimet të cilat duhet të bëhen në propozimin e projektit buxhetit për vitin 2017 të cilat janë pjesë përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni tha se dëgjua drejtorin për ndryshimet që përmendi në buxhet të cilat i kemi aprovu edhe në komitetin për politike dhe financa dhe duhet t'i keni parasysh këto ndryshime. Pastaj e hapi shqyrtimin:

Agron Hajdini, drejtori bëri prezentimin e buxhetit dhe në si grup parlamentarë ekemi shqyrtu këtë buxhet i cili për vitin 2017 kap shumën, prej 14.025.258,00 duke përmendur ndarjen e tyre sipas fondit burimor. Në krahasim bëri krahasimin e buxhetit për vitin 2016 me 2017, dhe 2017-2019 duke shtuar se buxheti është duke u rritur për çdo vit. Pastaj përmendi rritjen e investimeve kapitale, sipas planifikimit të buxhetit ku kjo rritje deri vitin 2019 do të jetë 495995,00. Për vitin 2017 me këtë projekt buxhet janë përfshirë të gjitha fshatrat për investime në projekte, për vitin 2018 janë parapa ndërtimi i 6 qerdheve ku janë përfshirë dhe disa fshatra, në fund bëri krahasimet e rritjes së të hyrave vetanake që nga viti 2015.

Xhevat Olluri, mund të themi se është për lavdat shpërndarja e buxhetit që gati përfshiri të gjithë teritorin e komunës, po ashtu ma herët u përmendën 3 pagat deshta ta di a jemi në të obligueshëm këtë ta përfshijmë në buxhet. duhet të parashikohen me qenë se na e dimë sa punëtor do të dalin në pension, ku po shihet se edhe gjykatat po na obligojnë me bo pagesën, atëherë kemi shtesë mjete se po duhet me pagu edhe gjykatën. pasi komuna është fajtorë. prandaj është kan mirë me parapa në buxhet nëse nuk ka një pengesë, për të investimet kapitale unë pata një fjalë miradie për këtë, propozim nga kryetari dhe qeveria, është shumë i mirë se i përfshin gati të gjitha

vendbanimet,por nuk pom pelqen asfaltimi i rrugëve në fshatra,nuk është cek cilat rrugë do të asfaltohen me qenë se rrugët i kan emrat.u kan mirë të ceket cilat rrugë do të asfaltohen.prandaj qetu kam një vërejtje,Dje patëm nje takim me organizatën “Polis” dikun kan tepru dikun u dasht mu shtu deri ne 20000 eruo se nuk ka pas projekte ideore.me pas pas do te ishte një ndryshim ma i vogël qe do të ishte nërmale.Qështja e Divjakës është nje fshat i harruar,ku edhe veten po e fajsoj,që nuk është bër asgjë për atë vend na si kshillëtar të AAK-s nuk kemi naj propozim por nëse ka dikush naj propozim për ridestininim ose diçka tjetër na e përkrahim.është mirë qe janë përfshi edhe qerdhet po ado të kemi inplikime buxhetore për arsye se atje do të punësohet pënëtor të ri.a do të mundemi me realizu punësimin e tyre.

Imri Ahmeti me qëllim qe mos me u përserit edhe tjetrt këta që e tha Kryetari Olluri e kam marrë shqetësimin e shumicës së opinjonit,për fshatin Divjak,edhe kam propozim nëse pajtohet edhe asambleja,me hek një pozicjon,ideja është te investime kapitale numer 58 e keni nërtimi i rrethojva dhe infrsatrakturës në fshatin Magurë e kisha kodu rrugën e Divjakës

Ideja o kjo ktu jan vetëm 21 000 euro këto nuk dalin po me rëndei është me fut në kod buxhetor, se ma let e kemi për herat tjera,kjo o ideja sepse këtë e shti në kod buxhetor,ndërsa ajo ne Magurë ma let e marr përmes donacioneve.organizatava të ndryshme ose prej mbetjeve që prodhohen,dhe ndryshimi i dyt,është te fushat e vogla të fundbollit e keni Akllapin.Unë propozoj të hiqet fshati Akllap dhe të futet fshati Lluga,sepse nuk është asnjë projekt as në fshatin Lluga dhe tani me këtë përfshihen këto dy fshatra Divjka dhe Lluga.

Florent Hoxha,edhe ne si grup parlamaentar i PDK-së projektbuxhetin për vitin 2017e kemi shqyrtu.Ky planifikim në pamje më shumë i ngjan një pamje të fushatës zgjedhore,se sa është në realitet në zgjidhjen e nevojave të qytetarëve,ku me këtë nga egzekutivi shihet qart se tentohet të blihet vota e qytetarëve Lipjanas,Në planifikimin buxhetor 2017-2019 mund të shiheni një shumëzim,të projekteve me shuma të vogla,ku për se afermi nuk zgjedhin aspak nevojat e qytetarëve,ky planifikim është bërë pa një analize faktike të daljes në teren ku i është lën hapsir kryetarit të komunës të manipuloj sipas qefit të tij.dhe elektoratit të tij.Vërejtet tona si PDK janë më së shumti në investimet kapitale në kuadër të shërbimeve publike,në arsmen,shëndetësi dhe dikasteret e tjera.Unë edhe në KPF e kam pyet zyrtarin që e ka paraqit planifikimin buxhetor,se a janë harmonizu të gjitha projektet strategjike,dokumenet qe janë aprovu në kuvend, siq janë regulloret për efqienc, strategjia e e zhvillimit ekonomik, lokal, plani rregullativ i qytetit etj. Në shqyrtimin e planifikimit buxhetor në fillim nr 1 e keni bashkfinancimi me donator,që janë parapa 90 000 euro nga te hyrat vetanake,kjo shumë është e vogel dhe kërkoj te jetë ma e madhe,dhe mos te jetë prej të hyrave vetanake por një pjesë të jetë prej grantit qeveritar kurse pjesa tjetër të jetë nga te hyrat vetanake.Numër 3,mirëmbajtja e investimeve dhe ndriqimit publik,është mirë mu pëfrshi kjo po deri tani nuk e dimë cka ka ndodh me ndriqimin publik.Te pika 5 ndërtimi i sheshit “Adem Jashari” janë parapa mjete prej 250 000 euro për këtë vit, vitin e ardhshem 170 000 euro, dhe kjo është duke u bër në mënyrë të jashtëligjshem meqë ne si asmbleist nuk e dijm cfar ndryshime janë përfshi në planin regullativ, te Sheshi “Adem Jashari”, gjithashtu nuk e dijmë se me këto mjete ,a është përfshi ndonje statuj lirie apo përmendore komandantit legjendar “Adem Jashari”, apo deshmoreve dhe martirëve tjer qe janë në komunen e Lipjanit,

Vërejtjet tona janë në asfaltimin e rrugëve ne Lipjan rugen “Shipria” dhe “Hajredin Bajrami” kjo shumë prej 75 000 euro a e plotson komplet nevojat në mënyre që të përfshihet rruga katër korsi që është në zhvillim e sipër. Kemi vërejtje edhe për asfaltimin e rrugëve që shkojnë shumzim, nuk specifikohen. Ka qenë një zotim i krytarit, që kësaj herë le të shkon qysh është kurse në planifikimin buxhetor që vjen do të kemi të specifikuara edhe rrugët edhe lagjet, tash na kanë ardhë komplet jo të specifikuara dhe as për së afërmi nuk i plotsojnë kërkesat e qytarëve. Një vërejtje tjetër është ku thuhet asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë a na kemi dy Dobraja nuk ceket se për cilën Dobrajë është fjala. Për asfaltimin e rrugëve ne Shalë janë paraparë 65000 euro për vitin 2017 dhe ata 25 mij euro nga grandit qeveritar dhe 40 000 euro nga buxheti i komunes që sipas mendimit tim këto mjete nuk mjaftojnë për asfaltimin e rrugëve në Shalë e që na disa herë kemi kërku asfaltimin e rruges së “Korpuzve” që lidhet me lagjen e “Drenices” në gjatësi prej 1600 metra dhe këto mjete nuk e mbulojnë këtë rrugë e mos të flasim për tjerat, andaj propozoj që kjo shumë të jetë 65 000 euro të rriten në 100 000 euro dhe mjetet që teprojnë të investohen në ndonjë rrugë tjetër masi nuk janë definuar cilat rrugë do të asfaltohen. Në vazhdim për mënyrën e planifikimit të tretuarëve si dhe ndriqimin publik, pas specifikimit se në cilat rrugë do të behen tretuarët dhe ndriqimi publik. Pastaj tha se propozimin që u dha për rugen e Divjakës për zhavorim dhe u përkrash kjo është e mirë por une e di se këto mjete nuk mjaftojnë për atë rrugë, për zgjerimin e kanalizimeve në fshatrat nuk specifikohet se në cilat fshatra dhe kjo është bërë me qëllim që gjatë fushatës aty ku i thotë elektorati i përfshihet, të zhavorimimi i rrugëve për zonat industriale nuk është cek se cila zonë ekonomike në Qylage apo të QMI-ja. dhe konsideroj që duhet të definohet cila zonë, të pastrimi i lumëve nuk është cek se cilet lumë por vetëm janë parapa kodet dhe na duhet me ditë se cilet lumë janë pasi që une vij nga Drenica dhe duhet ta di a pastrohet lumi Drenica. Kemi parapa edhe ndërtimin e shkollave ku për një shkollë kemi parapa 83 000 dhe konsideroj se nuk mjaftojnë gjithashtu në të dim gjendjen e shkollave tregtare I kemi në Rubovc, Miren dhe Bregë të Zi dhe për Rubovc nuk e di a është zgjidhja qeshtja pronësore, Në vazhdim tha se më vjen mirë për disa shkolla është planifiku edhe nxemja qendrore mirpo nuk e di se shkolla mikëse e lart në Shalë a është përfshi për nxemje qendrore kur dihet se kjo shkollë është ndërtuar nga donacionet dhe komuna nuk ka investuar fare andaj kërkoj që në kuadër të këtij planifikimi të përfshihet edhe kjo shkollë, në këtë planifikim buxhetor unë nuk e pash se është planifiku hapja e rrugëve të reja e sidomos në qytet ku ka kërkesa të mëdha nga qytetarët me që ata i paguajnë lejet e ndërtimit. Gjithashtu ka qenë një kërkesë e kryetarit Xhevat që të parashihet ligjdhja e zonës urbane 2 me zonën 1 apo nënkallim ose mbi kallim të hekurudha. Se di a është planifiku dëkka ose jo.

Në fund tha se besoj që sygjërimet tona do të mirën parasysh me që ne kemi qenë në terren dhe e kemi vërtetuar atë që i cekim me heret.

Blerim Gashi, do të përpiqem të jem sa më i shkurtër në diskutimin tim, se sot nuk kemi mundësi të bëjmë ndryshimet në këtë buxhet. Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë projekt buxhet dhe është një Vendim shumë me rëndësi që duhet ta aprovojmë në asmblesistët me qenë se ky Vendim dhe ky projekt buxhet ka të bëjë me zhvillim ekonomik të komunes sonë. Është për të peshendetur ky vendim me që janë përfshirë të gjitha lokalitetet me projekte të ndryshme me gjithse u tha se ka edhe lokalitete që me këto projekt buxhet nuk u janë parapa investime fare. Sfidë për buxhetin e komunës është rritja e tavanit të hyrave vetanake të komunes ku konsideroj se nuk mund të bëjmë më

realizojm kete te hyr dhe mos realizimi sigurisht nuk do te mund te realizoj ndonje projekt qe e kemi parapa.Eshtë për ta pershendetur plaifikimin për ndërtimin e fshuave të sportit si në shkolla ashtu edhe në lokalitete të ndryshme dhe me këtë do të afrimohet sporti i te rinjëve .

Përkrahi edhe parafolsit sidomos profesorin Xhevat kur permendi se disa projekte siq janë për rrugë tretuare e tjera nuk janë përmend se cilat rrugë dhe ne si asmableistë duhet ta dim se cilat rrugë do te shtrohet.

Në fund permendi qeshtjen e realizimit te kontrates kolektive per arsim duke shtuar se këtë qështje e kam inicuar disa herë e gjithashtu edhe në KPF por drejtori i buxhetit e arsyetoj se në buxhet nuk mujm ta realizojm këtë kontratë me që nuk kemi mjete finaciare ndërsa qeveria nuk ka qit mjete për këtë qështje a ne e dim se ministri i arsimit ka thenë se kjo qështje është e pushtetit lokal dhe ne kete formë kontrata nuk po realizohet,une konsideroj se kjo eshte e ligjshme dhe kontrata duhet te realizohet.Na si grup paralamentar e perkrahim vendimin dhe projek buxhetin .

Ukë Kryeziu, sot po diskutojm projekt buxhetin per vitin 2017 qe eshte nder vendimet me te rendesishme per zhvillimin ne komunen tone,une isha ndal ne sektorin e shendetsise dhe mireqnes sociale te shendetisa primare,foli në cilisin e komitetit për shëndetsi,ku kemi majt nje takim ne fund te qershorit kur ka ardh qarkorja buxhetore për vitin 2017 dhe kemi dhën propozimet,ku ka qen i pranishem drejtori i shnedetsise dhe mirqenjes cociale Avdullah Fazliu, kur e shikoj kete buxhet e shoh qe ka kufizimet e veta por ne sektorin e shendetsise eshte dashte te ketë nje qasje me ndryshe kte do ta elaburoj edhe ma tutje pasi qe vi nga ai sektor,tek mallrat dhe sherbimet,i kemi investim 70 000 euro ndersa te komunalit 36 000 euro,investime kapitale 19 000 euro na jemi shume mirjnohs se eshte marr si propozim, ivestimet kapitale ku eshte cek te laboratorit por me ketë vler 19 000 euro vetem nje aparat mundemi me ble,neve na mungon gama e zgjerimeve laboratorike,mikrobiologjike edisa te tjera,qe jan te munshme te behen ne komunen tonë vetem vyn nje investim pak me i lart ne aparatur se stafin e kemi dhe gadishmeria nuk na mungon.Me 70 000 euro ne shendetsi a do te kemi ne mundesi ti mbulojm mallra dhe sherbime,ku higjena ka nje kosto te madhe ku eshte numri QMF ve,edhe gama e perdorimit te disa ambulancave te reja,po ashtu i kemi edhe auto garazhat,nga maslufta nuk eshte nda asnje cent per me ble nje autoambulanc,ku permes donatoreve kemi mbilejtu, Gjithashtu tha se kohen e fundit nga retsaruanti Anija kemi marr nje autoambulac donacion’ Pastaj tha ku kete vitë eshte ber nje qasje ma ndryshe,dhe stamatologjia ka ofru nje sherbim me te mire se sa ne te kaluaren.Problemin ma te madh e kemi te laboratorit ku her pas here po hasim ne probleme laboratorike per analiza. Nga minsitria e shendestis nuk marrim asnje cent per stamatologji,dhe laborator,Pastaj propozoj qe ne te ardhmen emregjenca te ndahet nga QKMF-ja dhe te ketë një objekt te vetin dhe kodin e vetë te financimit.Ne sektorin e faramaicis ku jam edhe une aty,jan ndar 12 000 euro per barna dhe keto mjete nuk mjaftojn per barrna.Pastaj foli lidhur me sektorin e matarnitetit ku kryhet sherbimet mirpo ne kete sektor mungojn mjetet e punes ku eshte vetem nje Ultra za dhe shume pacient nuk nalen ne kete sektor po shkojn ne Prishtinë.Ne vazhdim permendi QMF ne Janjev dhe Babush, janë laboratoret,por nuk funksionojn ne munges te aparatures.Ne fund uroj per kete buxhet dhe shperndarjen gjithperfshirse,por disa sektor kan mbet anash.duke shtuar se per shendetsi nga drejtori jan kerkuar 120 000 kurse jan ndar vetem 70000

per vitin 2017 te cilat nuk mjaftojn por besoj qe me redistinin te buxhetit do te ndahen mjete shites.

Lulzim Rrustemi.shefi i grupit paralamnar i PDK-s i paraqiti shumicen e vertjeve por une do te ti paraqes disa veretje ma konkrete si vijon:te investimet kapiatle te buxhetit per vitin 2017-2019 perfshihet ¼ e buxhetit dhe une mendoj se kjo shume duhet te rritet se nuk mjafton per investime kapitale.Te zyra e kryatrit per subvencione jan parapar 157000 euro subevencione dhe mendoj qe jane shume dhe propzoi qe nga ky pozijon 50 000 euro te barten ne bujqesi.Te te hyart vetanake planifikimi eshte i madh dhe konsideroj se eshte e veshtir te realizohen me qe duhet nje kohe dhe nese nuk realizohen te hyrat rrezikohen disa projekte qe jane te parapara pëer viin 2017 .Te bujqesia jan planifiku 126 000 euro ky prej tyre 26 000 jand grand qeveritar dhe 100 000 nga te hyrat vetnaka kjo shume mendoj qe eshte e vogel per bujqesi per kete propozoi qe 50 000 euro te barten nga zyrae e kryatrit te parapara per subvencione,Te planifikimi uraban jan parapa 129 000 euro cka mendoj qe se keto mjete nuk mjaftoj per projekte detale dhe harta zonae.

Te mbrojtja e mjedisit dhe turizmi planifikimi eshte “zero”

Te shendetsia plaifikimi është minor dhe dihet qe disa vite nuk ka pas investime per shendetsi.Te prioritetet e projekteve jan te perfshira 73 projekte dhe shperndarja perfersisht eshte ne menyre lineare,mirpo kemi fshatra e jan parapa 5-6 projekte ndersa disa fshatra siq jan Divjaka Kojska,Brusi dhe Lluga nuk eshte parapa asnje projekt andaj konsideroj qe eshte buxhet per fusht elektorale edhe gjithashtu kemi lokalitete qe nuk eshte parapar asnje projekt.Te sheshi Adem Jashri mendoj se planifikimi eshte jo ligjor se nuk i ka kalu procedurat per ndryshim te prijketit detal qe jan aprovu ma heret ne kuvend, ne fund tha se komiteti per planifikim dhe urbanizem lidhur me kete buxhet ka dhan 3 rekomadime:

- 1.Shuma e planifikuar prej 129 000 per hartimin e projekteve të rritet
- 2.Të emertohet rruget ne te cilat do të ndertohen
- 3.Rregulimi i parkut te shetpia e Kultures “Tahir Sinani” ne Lipjan

Edita Gashi.ne fillim u tha qe projekti eshte gjithperfshires,por dnoshta tash ju afru gjithperfshirjes pasi qe Kryatari me von e shtoi fshatin Divjak dhe Llugë,Ne arsim perveq qe kemi nevoj te risim cilsin jemi deshmitar edhe te problemeve te shumta ne duhet te planifikojm dicka per reduktimin e ketyre qeshtjeve qe kan te bejn me adolishentet,pershembull ritja e psikolegeve ne shkolla qe komuna veq ka fillu punsimin e disa psikolegve,u permenden edhe problemet ne shendetsi ku qendrimi eshte i pandryshshem dhe ne si grup paralamenatr i vetevendosjes dhe jemi kunder.

Ramiz Qiriri,eshte per tu respektur ky projekt sepse i keni perfshi te gjitha fshatrat,te gjitha lokalitetet tash ado te mund ti realizoni nuk edi,Kam disa propozime te fushat e futbollit te vogel te vendosen edhe koshat per basketboll,Tjetra te fshati Krojmir o mire nje rrug nga qendra e fshatit deri ne gryk nalt ku kan shpetu disa faimilje,atje ajo rrug eshte historike dhe ja mundeson qytatarve te Krojmiri ne te ardhmen me bo nje qender te turizmit.

Eshte mire te ndahete nje buxhet per mirmbajtjen e monomentev kulturore,pse jo edhe nje person te paguhet, Fshati Divjak nuk eshte veq i Lipjanit eshte mire qe qeveria te na ndihmoj pasi qe ju e keni kryeminsitrin tuaj shfrytzone.

Burbuqe Ilazi.sa do qe kryetari qe eshte mundu me i perfshi te gjitha fshatrat,fshatin Kleçkë se ka perfshi,as ne rrug as kanalizim as ne renovimin e shkolles

që u kanë kërkesë e jemja edhe e ma hershme edhe ekam një pyetje për lidhjen e ruges Torine Puturoc një sqarim rreth asaj rruge..

Imri Ahmeti, faliminderit për diskutimet që i dhat dhe unë do të mundohem të ju përgjigjem.

Së pari po lidhem te buxheti i vitit 2012 i cili është nënshkruar nga Luli me të cilin buxhet janë parapa vetëm 21 projekte për 16 fshatra. Në vitin 2013 janë parapa 23 projekte dhe prej tyre janë realizu 17 projekte kurse 9 prej tyre është tejkalu shuma e paraparë buxhetore mbi atë që është aprovu.

Po më vjen shumë interesant kur thoni se janë harru 3 fshatra a në anën tjetër po e bëni problem thoni pse i keni parapa shumë fshatra dhe këtë e keni bërë për vota. Pastaj pyeti se a mundet dikush me m'u përgjegjë e me cilin buxhet dhe i cilit vit në Komunën tonë apo edhe në komunat tjera i ka përfshi të gjitha fshatrat amna një shembull, por nuk ka shanc që është bërë kjo, a na mujna me bërë politikë, por shtrohet pyetja se cili është buxheti i këtij viti dhe konsideroj se ky buxhet për neve është gjithëpërfshirës. Pse vitin e kaluar buxheti ka qenë më i vogël me më pak projekte dhe kjo ka ndodh për shkak të borxheve që kemi trashëgu. Nuk është e vërtetë që na e kemi hjek rrugën e Divjakës por shumën e paraparë për Divjakë e ka hjek thesari me vendim, dhe ju lutem mos shpekuloni se e kemi hjek na. Rruga e Shalës që po përmendet na akoma e kemi pa paguar "Eurokosit" mjetet që edhe për këtë rrugë mundet thesari me na i hjek mjetet në vitin e ardhshëm. Këtu pata edhe një diskutant që buxheti është rritë në kurriz të qytetarëve, më thoni se cilën taksë e kemi qitë na si ekzekutiv, bile aty ku kemi mund me i hjek taksën e kemi hjek. Unë po mendoj me i hjek do taksa të ndërtimit të cilat do ndihmojnë bizneset se nuk është në rregull me thirr investitor në Lipjan dhe me i detyru me paguar taksë ndërtimore ndoshta 1 milion euro. Pat pyetje konkrete te bujqësia dhe ju them se na kemi gjetë 16 mijë euro për bujqësi kur tani e kemi rritë buxhetin në 126 mijë euro dhe pretendohet një farë forme gjëja se kurgja nuk kemi bërë ku jeni kanë ju 16 mijë euro i keni pas në buxhet.

Subvencionet e Kryetarit, nuk janë subvencionet e Kryetarit! Këto janë subvencione të Kuvendit që i kanë ndarë dhe shumica e tyre shkojnë për varrime dhe kategoritë tjera të caktuara.

Te të hyrat vetanake edhe një herë po e potencoj se u tha të zvoglohen mjetet për mallëra dhe shërbime dhe kategori tjera dhe të rriten investimet kapitale. Në vitin 2014 për investimet kapitale kemi gjetë vetëm 2 milion e 400 mijë euro kurse tani i kemi rrit mbi 3 milion dhe kjo rritje është produkt i rritje të të hyrave vetanake. Arsyeja për mos emërtimin e rrugëve në fshatra në të cilin investohet, është e vërtetë e kam thënë që ditën kur vjen propozim buxheti do të provojmë me i emërtu rrugët, por pse ska ndodh kjo janë një mijë arsye; E para sistemi nuk i nxen mbi 50 germa për të futë të dhënat e 2-3 rrugëve në sistem se 2-3 rrugë me i shkru bëhet 50 germa. E dyta në vend se të kemi 90 projekte na bëhet 180 projekte. E treta a mundemi me 3-4 apo 5 punëtorë me i menagju këto projekte.

Çështja e sheshit "Adem Jashari" është përmend edhe më herët dhe po e sqaroj se asnjë ndryshim nuk është. Është e vërtetë se sheshi është shpallë faza e parë për platon dhe rrugët por jo për ndërtimet meqë ndërtimet nuk mund të bëhen deri sa kemi probleme me pronat. Ata që se kanë bërë lapidarin e "Adem Jasharit" ne do ta bëjmë dhe e kemi parapar vendin ku do të bëhet ky lapidar dhe ky lapidar nuk bëhet për Imri Ahmetin apo Florent Hoxhen por e kemi obligim.

Hapja e shtretërve të lumenjëve, zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve që më heret e ngriti dikush por është e pamundur me ditur se ku do të ket nevojë me intervenu në ndonjë kanalizim të supozojmë se do të prishet.

Për rrugët që janë paraparë ju them se çdo rrugë është e matur dhe për një pjesë të tyre janë edhe projektet. Nuk është korrekte që për fshatrat që nuk janë përfshi që të shkoni atje dhe t'u thoni se juve nuk ju kanë përfshi në asnjë projekt se nëse nuk janë përfshi për ate vit do të përfshihen për vitin vijues dhe asnjëherë me buxhetin për një vit nuk mund të përfshihen të gjitha fshatrat.

Florent Hoxha, me sa e vërejtja unë Kryetari ka gjetë 4-5 pika që qdo herë po i përmend që pse se keni bërë këte apo ate dhe po i them publikisht se po merret me të kaluarën a neve çdo herë na thon mos të merremi me të kaluaren.

Ju Kryetar po bëni krahasimet e buxhetit të vitit 2012, 2013 dhe 2014 dhe tani rritja e këtij buxheti nuk është rezultat i juaji meqë tavani i të hyrave vetanake dhe investimet kapitale vijnë drejtpërdrejtë nga niveli qendrorë dhe ju nuk mund t'i levizni këto.

Te borxhet që po i përmendni Kryetar 7 milion euro ju lutem sillna një listë për këto borxhe. Për rrugën e Shalës që është kryer është e vërtet se është borxh por për punët e kontraktuara ato nuk janë borxhe. Për projektet që janë parapa për vitin 2017 e thotë Kryetari se vështir është me i menaxhu por është e vështirë se këto janë projekte për fushatë. Për projektet detale që u përmendën ne do të kërkojmë me shkrim se cilat projekte janë në mënyrë që të dijmë. Sa i përket rrugëve u tha se i keni paramasat dhe parallogarit dhe kjo nuk qëndron dhe nëse i keni që po thoni është mirë që të na i sillni këto paramasa dhe parallogari. Për mirëmbajtjen e kanalizimeve e keni kompanin e kontraktuar dhe nuk keni nevojë me parapa mjete për këtë e për zgjerim të kanalizimeve është diqka tjetër.

Imri Ahmeti, nuk e dijë pse po ngritet toni kaq shumë pa asnjë arsye dhe unë jam shumë i relaksuar. Krahasimin që po e përmendi po ju dhemb shumë po skam qare pa e krahasu shembull për rrugën 4 kursi keni pasur vetëm 100 mijë euro dhe për këtë rrugë keni lidhur kontratë dhe e keni nënshkru në shumën 2.880.000,00€ për shenimet që po i kërkonin unë e dijë se ju kemi dhënë të gjitha shenimet llajf dhe i keni në shtëpi gjeni edhe obligimet kontraktuale edhe borxhet. Në vazhdim tha se vetëm për gazetën sport keni lënë borxh 13 mijë euro. Për projektet detale nuk thash që i kemi por thash i kemi parametrat real për rrugë. Po ju siguroj edhe një herë se unë kam me u angazhu me i realizu këto projekte, por këto projekte nuk mund të realizohen pa ndihmën e publikut dhe qytetarëve. Për të hyrat vetanake ndoshta unë kam pas qef me parapa vetëm 1 milion euro dhe këto të hyra me i realizu në qershor me 100% dhe kam mund mi parapa vetëm 3 projekte dhe i kisha mbikqyrë shumë mirë por e kemi caktuar një limit në mënyrë që drejtorët të jenë të angazhuar nënstop. Nuk e dijë pse dikuj nuk i pëlqen që Lipjani qe 3 vita rresht ka marr shpërblime dhe uroj qytetarët e Lipjanit për këtë performancë.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit, tha se meqë diskutime tjera nuk ka procedojmë me votim për buxhet por para se të votojmë unë po them se drejtori i përmendi disa ndryshime dhe me ato ndryshime bëhet 74 projekte e gjithashtu edhe Kryetari propozoj disa ndryshime dhe profesori Xhevat që të hynë edhe Divjaka dhe Lluga dhe propozimi i Florentit ku është Dobrajë të thuhet Dobrajë e Madhe e gjithashtu

edhe minusin e mjeteve e keni në arsyetim të vendimit të pagat andaj vejë në votim propozimin e vendimit me këto ndryshime që i ceka; kush është për.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 10 kundër miratoi këtë:

VENDIM
MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2017-2019

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2017-2019 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2017-2019 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Grant i Përgjithshëm	4,545,468.00	4,851,281.00	5,090,886.00
Grant Specifik i Arsimit	5,784,564.00	5,784,564.00	5,784,564.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,426,679.00	1,426,679.00	1,426,679.00
Të hyrat vetanake	2,108,547.00	2,108,547.00	2,135,237.00
Financimi Sherbimet Rezedenciale	160,000.00	160,000.00	160,000.00
TOTALI	14,025,258.00	14,331,071.00	14,597,367.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Paga e Mëditje	8,772,802.00	8,795,177.00	8,807,228.00
Mallra dhe Shërbime	856,366.00	874,413.00	904,413.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	198,390.00	195,098.00	191,098.00
Subvencione dhe Transfere	329,067.00	330,000.00	330,000.00
Investimet Kapitale	3,868,633.00	4,136,383.00	4,364,628.00
TOTALI	14,025,258.00	14,331,071.00	14,597,367.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim Vendimi mbi miratimin e ri-destinimit dhe transferit të mjeteve buxhetore për vitin 2016

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Drejtorit për Buxhet dhe Financa Shkelzen Hajdini i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, ne si këshillëtar të grupit parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim për ridestinim të mjeteve dhe besojmë se ekzekutivi i ka paraparë këto mjete që kanë tepër dhe ridestini i tyre është bërë në mënyrë të drejtë për realizimin e projekteve të reja .

Feriz Hasani, edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe të njëjtin e përkrahim

Blerim Gashi, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim për ridestinim të mjeteve dhe po shihet se gjatë realizimit të projekteve po teprojnë mjete dhe nga këto mjete janë hy një pjesë e projekteve të reja mirëpo po më intereson cili është projekti i ri për Sllovi e gjithashtu për Banullë e kam të pa kuartë që është hiqë tërësisht projekti.

Ukë Kryeziu, edhe ne si grup parlamentar i AAK-së e përkrahim fuqishëm këtë propozim vendim vetëm kërkoj sqarim nga Drejtori për fushën e sportit në Akllap e kemi të paraparë me buxhet por ka hy edhe në ridestinim.

Skelzen Hajdini, te pyetja e Blerimit për projektin në Sllovi është një park në Sllovi – te Xhamija dhe ka qenë kërkesë e qytetarëve për rregullimin e këtij parku.

Te projekti i Banullës ka qenë projekt i këtij viti për hapjen e shtratit të Lumit dhe e kemi shpall tenderin për këtë projekt por menaxheri i projektit e ka ndërprerë kontratën me operatorin për shkak të mos realizimit e punëve andaj ky projekt financohet nga granti qeveritar dhe për mos me humb mjetet e kemi tërhequr projektin e Banullës dhe ato mjete i kemi parapa në projekte tjera.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani Hajnuni, vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për 1 kundër miratoi këtë:

VENDIM

MBI RIDEDESTINIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE TE BUXHETIT PËR VITIN 2016

Neni 1

Me këtë Vendim ridestinohe dhe transferohen mjetet nga Buxheti i vitit 2016 në kategorinë e Investimeve Kapitale në shumë prej **146,420.42€**.

Neni 2

Sipas këtij vendimi, Kryetari i Komunës pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave, mund të bartë mjetet buxhetore ashtu siq është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi:

Neni 3

Mjetet Ridestinohe/Transferohen nga kjo ndarje buxhetore si vijon:

TRANSFERI I BUXHETIT NGA GRANTI QEVERITAR (10) - INVESTIME KAPITALE :

Ridestinimi i mjeteve:

1. Mjetet e mbetura nga programi Shërbime Publike MCE(180),Nënprogrami Infrastrukturë Publike (18163) nga projektet:

-Mirëmbajtja e ndriçimit publik -Fondi burimor(10)kodi i projektit (40167)shuma prej119.60€
-Ndërtimi i lapidarëve në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve Kraishtë dhe Ribar i Madh-Fondi burimor (10)kodi i projektit (41841)shuma prej.....2,658.94€
-Asfaltimi i rrugicave në Topliqan i Vjetër - Fondi burimor (10)-kodi i projektit (41842) shuma prej.....1044.74€
-Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë - Fondi burimor (10)-kodi i projektit (41843) shuma prej.....2,697.00€
-Ndërtimi i rrugicave me kubëza në Janjevë- Fondi burimor (10)-kodi i projektit (41845) shuma prej.....4,703.56€
-Asfaltimi i rrugëve Brenda qytetit të Lipjanit- Fondi burimor (10)-kodi i projektit (43056) shuma prej.....8,114.16€
-Asfaltimi i rrugës dhe infrastruktures në varrezat e Lipjanit - Fondi burimor (10)-kodi i projektit (43059) shuma prej.....6,035.65€
-Asfaltimi i rrugës Dobrajë e Madhe-Qylagë dhe rrugëve brenda fshatit Dobrajë - Fondi burimor (10)- kod i projektit (43063) shuma prej.....2,228.85€

Ridestinohen në projektet:

-Mirëmbajtja e ndriçimit publik ne qytet dhe fshatra - Fondi burimor (10), kod i projektit (i Ri) shuma prej ..5.000.00€
-Ndërtimi i parkut në Sllovi- Fondi burimor (10)-kodi i projektit (i Ri) shuma prej8,000.00€
-Rregullimi i çeshmes (currelit) dhe infrastrukturës në Leletiq-Fondi burimor (10), kod i projektit (i Ri) shuma prej.....6,500.00€
-Hapja dhe zhavorimi i rrugës për Hanrovc- Fondi burimor (10)-kodi i projektit (i Ri) shuma prej..... 8,102.50€

Tranferet e mjeteve:

Mjetet e mbetura nga programi Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami Infrastrukturë Publike (18163) nga projektet:

-Asfaltimi i rrugës Dobrajë e Madhe-Qylagë dhe rrugëve brenda fshatit Dobrajë - Fondi burimor (10)- kod i projektit (43063) shuma prej.....6,350.59€
-Ndërtimi i trotuarëve në fshatin Llugaxhi- Fondi burimor (10) kod i projektit (43069) shuma prej.....10,799.41€

-Ndërtimi i trotuarëve në fshatin Ribar i Madh- Fondi burimor (10) kodi i projektit (89254) shuma prej.....700.00€
-Blerja e e-Kioskut –Fondi burimor(10) kodi i projektit (41846)shuma prej150.00€

Transferohen në projektin:

Programi Kulture, Rini dhe Sport (850),Nënprogrami Kulture, Rini dhe Sport, kodi i programit (85003):

-Ndërtimi i fushes së vogël të sportit në Akllap -Fondi burimor (10) kodi i projektit (i Ri)shuma prej18.000.00€

Mjetet e mbetura nga programi Shërbime Publike.MCE(180), Nënprogrami Infrastrukturë Publike (18163) nga projekti:

-Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Banullë- Fondi burimor (10) kodi i projektit (43097) shuma prej.....65,000.00€

Transferohen në projektin:

Programi Arsimit dhe Shkencë (920), Nënprogrami Arsimit Fillor (93060):

-Ndërtimi i shkollës fillore Fsh.Bujari -Fondi burimor (10) kodi i projektit (87259) shuma prej65.000.00€

**Totali i mjeteve të ridestinuara/transferuara nga fondi burimor (10) është:
110,602.50€**

RIDESTINIMI I BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE (21) - INVESTIME KAPITALE:

-Mirëmbajtja e ndriçimit publik -Fondi burimor (21)kodi i projektit (40167) shuma prej14.000.00€

-Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë - Fondi burimor (21)-kodi i projektit (41843) shuma prej.....4,411.00€

-Asfaltimi i rrugës Dobrajë e Madhe-Qylagë dhe rrugëve Brenda fshatit Dobrajë - Fondi burimor (21)- kodi i projektit (43063) shuma prej.....15,000.00€

-Eliminimi i deponive të egra- Fondi burimor(21)kodi i projektit (43075) shuma prej 406.92€

Ridestinohen në projektet:

-Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra- Fondi burimor (21) kodi i projektit (i Ri)shuma prej.....5.000.00€

-Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve në Sllovi, Gadime e Ulët, Lipjan, Dobrajë e Vogël, Marevc, Dobraje e Madhe, Magurë dhe fshatra tjera -Fondi burimor (21) kod i projektit (i Ri) shuma prej.....15,000.00€

-Hapja dhe zgjerimi i lumenjëve në fshatra-Fondi burimor (21) - kod i projektit (i Ri) shuma prej10.000.00€

-Ndërtimi i parkut në Sllovi- Fondi burimor (21) -kod i projektit (i Ri) shum prej.....3,000.00€

-Hapja dhe zhavorimi i rrugës për Hanrovc- Fondi burimor (21) -kod i projektit (i Ri) shuma prej..... 817.92€

Tranferet e mjeteve:

Mjetet e mbetura nga programi Shërbime Publike MCE(180), Nënprogrami Infrastrukturë Publike (18163) nga projekti:

-Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë - Fondi burimor (21) - kod i projektit (41843) shuma prej.....2,000.00€

Transferohen në projektin:

Programi Kulture,Rini dhe Sport (850),Nënprogrami Kulture, Rini dhe Sport kod i programit (85003):

-Ndërtimi i fushës së vogël të sportit në Akllap -Fondi burimor (21) kod i projektit (i Ri) shuma prej2,000.00€

Totali i mjeteve të ridestinuara/transferuara nga fondi burimor (21) është: **35,817.92€**

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi

IV

Informatë nga DKA mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasanit, Drejtor i DKA-së i cili fillimisht tha se këtë informatë e kam përgatit me shkrim me kërkesën e Kuvendit. Në vazhdim njoftoj me të dhënat nga informata e cila është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë informatë dhe shihet se është një përshkrim i përgjithshëm pa e specifikuar aktivitetet nëpër shkolla dhe fare nuk bëhet fjalë për pranimin e kuadrit arsimor dhe për zgjedhjen e drejtorëve. Unë kam disa pyetje si vijon:

E para sa nxënës janë pranë në arsimin e mesëm dhe të lartë përkatësisht në klasën e 10-të. Sipas udhëzimit administrativ në një klasë duhet të jenë 32 nxënës a maksimumi 35. Pas mbylljes së konkursit nga DKA-ja është publikuar lista e pranimit dhe është në rregull, mirëpo pas fillimit të mësimit kjo gjendje ka ndryshu meqë në një klasë janë mbi 40 nxënës dhe kjo tregon se 120 nxënës janë pranë jashtë konkursit dhe shtrohet pyetja se qfarë cilësie të mësimit do të ketë në këtë shkollë.

Degradimi dhe shkatërimi i mësimit në komunën tonë po ndodh edhe gjatë zgjedhjes së drejtorëve nëpër shkolla të cilët janë zgjedhë në mënyrë të kundër ligjshme. Për ish drejtorin Feti Buja nga Drejtoria i arsimit është lëshuar referencë për sukseset që ka arritë në shkollën në Bujan e cila ka zënë vendin e parë në nivel vendi por edhe për kundër kësaj nuk është zgjedh Drejtor.

Në panelin përzgjedhës të kuadrit kanë qenë ekonomista dhe jurista të cilët i kanë intervistuar kandidatët që kanë përvojë në arsim me 24-25 vite.

Në Kroymir ka dalë në pension një punëtorë dhe konkursi është shpall për zëvendësim e në këtë rast nuk duhet të jetë konkursi për zëvendësim por për pranim, por kjo është bërë me qëllim për ta qarë dikë të vetin. Në gjimnaz nuk shpallet konkursi për profesor të matematikës.

Suksesi i nxënësve krahasuar me vitet e mëparshme ka rënë. Shpallja e konkursit për Florim Budakovën dhe Edita Bajrami ka qenë i kundërligjshëm dhe pas intervenimit të inspektionit është anuluar konkursi dhe janë pranuar ata. Për mësimin zgjedhor ka shkelje ligjore dhe ndërhyrje të vullneti i nxënësve dhe këshilli i prindërve meqë këto bëhen vetëm për ta caktuar dike të njohshëm për mësimin zgjedhor. Në shkolla kemi kuadër të pa diplomuar që punojnë dhe nuk e dijnë pse nuk shpallen ato vende të punës. Në shkollën mikse në Shalë janë shpallë vetëm dy vende të punës për matematikë dhe gjuhë angleze kurse për teknologji informative nuk është shpallë konkursi. Në fund ngriti qështjen e caktimit të mësimdhënësve në komisionin për testet e arritshmërisë të cilët janë caktuar vetëm nga pozita dhe asnjë është zgjedhë anëtar i këtij komisioni nga subjektet në opozitë.

Xhevat Olluri. Falenderoj Drejtorin për paraqitjen e kësaj informate mirëpo ka mundësi me qenë më detale, megjithatë ka disa informata bazë që mund të bisedojmë rreth tyre.

Së pari në informatë është dashtë të paraqitet kuadri arsimor, sfidat rreth realizimit të reformave se sa po munden me u përcjellë dhe realizu. Unë e di që ka probleme në arsim jo vetëm në Komunën tonë por edhe në përgjithësi në Kosovë sepse jemi në një fazë ku po kërkohet me i plotësu disa standarde në nivel evropian. Në informatë nuk është përmendur se a ka kuadra të mjaftueshme dhe adekuate për të gjitha lëndët mësimore. Për mësimin zgjedhor këtë e zgjedhin nxënësit dhe këshilli i prindërve dhe kjo nuk mund të jetë zgjedhje kolektive dhe nuk është mirë që një klasë e tërë të ketë vetëm një lëndë zgjedhore. Nxënësit që janë në gjimnaz sidomos ata të drejtimit shkencor nuk janë të gjithë të shkelqyeshëm dhe u tha se nuk po plotësohet numri në qershor, andaj në afatin e dytë pranohet edhe ata që nuk janë të shkelqyeshëm dhe unë po them se për gjimnaz shkencor duhet të pranohen nxënësit të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret dhe nuk mund të pranohen nxënësit që nuk e njohin lëndën e matematikës. Lëndën e astronomisë munden me e dhënë vetëm profesorët e fizikës e jo sikur që ndodh te ne që këtë lëndë ta japin edhe profesor tjerë. Në fund propozoj që të zhvillohet një aktivitet me nxënësit e shkollave fillore të cilët nuk kanë mundësi të regjistruar në

gjimnaz në mënyrë që të rexhistrohen edhe në degët tjera të shkollës profesionale siqë është bujqësia, teknologjia e përpunimit të pijeve, teknologjia e produkteve ushqimore etj. sepse për këto mund të hapen edhe vende të reja pune.

Hajrije Salihu, unë po pajtohem me Drejtorin se investimi në arsim është investim në ardhmërinë meqë arsimi është shtylla kryesore unë ashtu mendoj dhe ashtu duhet të jetë edhe në të ardhmen. Unë e kam lexuar me vëmendje informatën dhe si informatë nuk është e gjatë dhe ka mund të jetë më konkrete. Arsimi në përgjithësi në Kosovë nuk është duke u trajtu mirë. Pamvarësisht se na kemi ndërtu shkolla dhe infrastrukturë dhe unë shpesh herë bëjë krahasime të gjeneratës sime dhe gjeneratat e tashme dhe ne i kemi pasur punët më mirë se këta të tashmit dhe e di, se tani na ka vërshu teknologjia por po e përserisë se gjeneratat tona shumë gjëra i kanë pasur më të mira se këta tani. Në vazhdim tha se kam pyetje me Drejtorin se qka ka bërë për nxënësit me aftësi të kufizuara për bartje në shkollë dhe anasjelltas. Për shkollën “Adem Gllavica” se është bërë renovimi i një pjesë por dyer dhe dritare të kësaj shkolle janë katastrofë. Gjithashtu në shkollën “Adem Gllavica” jemi kahë ballafaqohemi me mungesën e një fotokopjuesi me kapacitet të lartë për nevoja urgjente të shkollës. Në provimin pranus në fakultet nxënësat tonë qalojnë në matematikë, andaj pyes Drejtorin se qka ka bërë për kuadrin e profesorëve të matematikës dhe konsideroj se studentat e kësaj lënde duhet të stimulohen. Për mësimin zgjedhor edhe unë kam vërejtje se mësimi zgjedhor nuk duhet të jetë nevojë vetëm për arsimtarë për sigurim të vendit të punës dhe nxënësve nuk po ju japim alternativ dhe po i detyrojmë të mësojnë vetëm këtë apo atë lëndë.

Blerim Gashi, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e kësaj informate dhe për këtë informatë ka mjaft qka të flitet.

Së pari pyes Drejtorin se cila është kostoja e zbatimit të kontratës kolektive dhe pse nuk po aplikohet kjo kontratë. Për cilësinë në arsim dihet se ne të gjithë e kemi qëllimin si të ngritet cilësia dhe këtë duhet ta kemi imediatë. Gjimnazi ende nuk e ka kriterin dhe duhet ta qesim vijën e kuqe që në gjimnaz paraleja të ketë 32 nxënës dhe pikë se me 40 nxënës në klasë nuk mund të kemi cilësi në arsim dhe nëse këtë e bëjmë atëherë hapet rruga edhe për drejtime profesionale. Komuna jonë qalon shumë në matematikë se nxënësit të cilët regjistrohen në fakultet nga Komuna e Lipjanit janë më të dobët në matematikë dhe unë nuk e di se qfarë arsimtarë kemi për matematikë në shkollat fillore.

Kushtet në shkollën “Adem Gllavica” janë të vështira dhe nuk i tërheqë nxënësit me ndejtë në ato lokale, por besoj se vitin e ardhshëm do të fitohet ndonjë donacion për meremetimin e kësaj shkolle dhe për këtë kam biseduar me Drejtorin e buxhetit për renovim të kësaj shkolle. Sa i përket propozimin e Hajrijes për hapjen e bives edhe unë e konsideroj se është shumë e rëndësishme hapja e bives meqë edhe nxënësit edhe arsimtarët kanë nevojë që të ushqehen. Në fund tha se ka nevojë për depolitizim në këtë shkollë dhe politika duhet të jetë larg shkollës.

Nazmi Krasniqi, lidhur me këtë informatë u them se viti i ri shkollor nuk ka filluar mirë dhe ka filluar me vonesë. Pastaj tha se me Ligj parashihet që për pranimin e kuadrit të shpallen dy konkurse, konkursi i rregullt dhe konkursi plotësues dhe që 3 vite është shpallur vetëm konkursi i rregullt dhe nuk ka pasur konkurs plotësues dhe këtu tani janë bërë manipulime në pranimin e kuadrit. Pranimi i Drejtorëve është bërë në mënyrë jo ligjore dhe tani janë në procedurë gjyqësore. Pranimi i kuadrit arsimor është në nivelin më të ulët dhe njerëzit planifikohen për vendet e punës pa u shpallur konkursi dhe

disave u premtohet që në qershor për mësimin zgjedhor e gjithashtu disa konkurse shpallen në baza politike si shembull po e marr për Florim Budakovën dhe Edita Bajramin është shpallë konkursi për vendet e tyre dhe pas intervenimit të inspektionit ky konkurs është anuluar. Hyzer Rizani është doktor i shkencave biologjike dhe nuk i ka orët e plota dhe disa orë ju kanë dhënë njerëzve të rinjë. Në vazhdim pyetje Drejtorit se sa mbledhje ka mbajtur me nxënësit dhe prindërit, gjithashtu përmendi rritjen e mungesave të nxënësve dhe arsimtarëve. Në fund tha se në këtë informatë nuk janë bërë krahasimet me vitet paraprake në mënyrë që t'i shohim rezultate se a kanë rënë apo janë në rritje.

Nehat Terpeza, falënderoj Drejtorin për paraqitje të informatës e cila informatë pasqyron të arriturat, rezultatet dhe sfidat që është ballafaqu DKA-ja. Në informatë u paraqitën investimet kapitale të cilat janë bërë për krijimin e kushteve më të mira të punës në procesin edukativo arsimor dhe kjo po përcillet me ngritjen e cilësisë në arsim dhe pranimin e kuadrove adekuate. Unë po lidhem në shkollën time ku ka pasur mungesë të kuadrit muzikor por edhe ai është plotësuar me kuadër profesional. Në këtë informatë e pamë se është punuar mjaft mirë ku janë paisë shkollat me televizor "SMART" nxemje qendrore ndërtimi i fushave shportive, transporti i nxënësve si dhe furnizimi i dy shkollave të mesme me paisje kabinetike. Unë uroj që Drejtori të përmbyll në të ardhmen edhe sfidat prej 10 pikave që i ka paraqitë në informatë.

Daut Azemi, fillimisht përshëndes Drejtorin për punën që ka bërë prej fillimit të mandatit të tij duke marrë parasysh gjendjen katastrofale që ka qenë në arsim dhe e dijmë se ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm. Pastaj pyeti se në Babush kemi dy shkolla ku në mandatin e kaluar në Gadime është ndërtuar një shkollë ku distanca e shkollës së Babushit është vetëm 100 metra dhe pyes se a ka mundësi që te na të organizohet mësim me një orarë (ndërrim) siqë është bërë në Janjevë e disa shkolla tjera meqë aty ka hapsirë të mjaftueshme.

Edita Gashi, qështja e parë që më ka ra në sy është gabimet drejtëshkrimore që një dokument i tillë zyrtar nuk guxon të ket këto gabime. Çështja e dytë është që më ka pëlqyer është nisma e pranimin të psikologëve në shkolla por ky numër nuk mjafton dhe propozoj që të rritet numri dhe së fundit është qështja e konkursit që konsideroj se duhet të publikohen emrat e kandidatëve që intervistohen dhe të dhënat e tyre lidhur me shkollimin adekuat dhe kështu e shohim se ata që punësohen janë meritore.

Burbuqe Ilazi, unë kam pyetje për Drejtorin se a ka qenë në vizitë ndonjëherë në Kleçkë me pa se në qfarë gjendje mbahet mësimi se unë disa herë e kam cekë se ajo shkollë ka nevojë për renovim.

Enver Kozhani, unë kam tri pyetje si vijon: e para për 3 pagat pas daljes në pension të punëtorëve a është obligim lokal apo qendror meqë shumica po i sigurojnë përmes gjykatave dhe konsideroj se kjo nuk është e drejtë pas 40 viteve punë

E dyta a janë përcaktuar nxënësit në ndonjë shkollë për mësim zgjedhor apo mësimi zgjedhor është imponuar përmes Drejtorit të shkollës dhe Drejtorit të DKA- dhe e treta që tri vite jeni në pushtet a keni planifikuar ndonjë burs për studentët në drejtimet shkencore.

Lulzim Rustemi, unë kam dy tri pyetje rreth informatës dhe të gjithë këshillëtarët e kanë parë se informata është e mangët ka mangësi profesionale për faktin se në procesin arsimor nuk duhet të fillohet prej fillimit të vitit shkollor por ka pas një proces tjetër për përzgjedhjen e kuadrit arsimor dhe një ndër kushtet për të pasur nivel të

arsimit cilësor siqë po e kërkojmë na do të duhej me krijuar kushtet për përzgjedhjen e nivelit më të mirë të mësimdhënësve dhe kjo mungon në këtë informatë dhe është e meta kryesore në këtë informatë. Enveri e tha se a ka ndonjë përpjekje për sigurimin e bursave për kuadrat deficitare por po e përsërisë edhe unë se është shumë me rëndësi për të ardhmen për procesin mësimor që të sigurojmë kuadrat deficitare. Në vazhdim pyeti se a ka bashkëpunim me shkollat që janë në Lipjan të minoriteteve meqë neve na intereson sa nxënës janë sa shkolla etj. dhe kjo mungon në këtë informatë.

Arben Bahtiri, për arsimin ka nevojë me diskutu se arsimi në Kosovë pas luftës është në krizë e ndoshta më keq se para lufte dhe ekzekutivi duhet të bënë përpjekje për përmirësimin e gjendjes në arsim. Ministria e arsimit ka bërë përpjekje për me apliku një test për mësimdhënësit dhe pse shumica e mësimdhënësve e kanë refuzuar këtë test dhe sipas mendimit tim diqka nuk është në rregull se këto teste e dijë se aplikohen në vendet në rajon dhe nuk duhet me ju frigu asnjë mësimdhënësi ku ky tekst është i dobishëm edhe për mësimdhënësit edhe për nxënësit. Çështje tjetër është rexhistrimi i nxënësve në shkollat e mesme dhe se për gjimnaz duhet të jenë kriteret dhe të pranohën nxënësit me nota të mira dhe ata që mbesin të rexhistrohen në drejtime tjera profesionale.

Ramiz Qeriqi, unë po e shoh këtu një lloj kfizi, pozita e lavdron Drejtorin kurse opozita flet keq dhe në shkolë nuk duhet me pasur politikë duhet me qenë a politik e me sa e dëgjova unë politika më e madhe bëhet rreth shkollës. Drejtorin nuk e kam dëgju por kam dëgju rrugëve se e kanë hjekë Fatmir Sopën dhe e kanë qu në Konjuh dhe në vend të tij është pranë gruaja e Drejtorit Astrit Bujës dhe nëse kjo është e vërtetë është marre.

Rasim Hasani, po filloj së pari me pyetjen e Luanit dhe nëse keni mundur me e përcjell në fillim unë e thash se kemi pasur probleme në këtë vit duke filluar prej Krojmirit e deri në Gadime meqë në tetë shkolla kemi pasur nga një klasë më pak qka do të thotë se kemi pasur 28 orë më pak. Sa i përket Fatmir Sopës ai nuk ka orë në “Adem Gllavicë” dhe e kam koleg dhe kam për obligim për me ja siguruar orët pavaësisht se ku dhe me këtë konsideroj se i kam bërë nderë dhe i kam plotësuar normën ku kam mundur. Sa i përket konstatimit se administratorët i kam zgjedhur në baza politike kjo nuk qëndron, e gjithashtu u tha se në panelin intervistues anëtarët kanë qenë jurist dhe ekonomist ju them me kopetencë të plotë se nuk ka pasur as jurist as ekonomist, Sa u përket zgjedhjes së drejtorëve kjo është bërë sipas udhëzimit administrativ dhe Ligjit dhe merrne dhe lexoni Ligjin dhe këtu jam i pastër. Te konkursi kemi thënë preferohet dhe kjo është në rregull. Sa i përket numrit të nxënësve në klasë në gjimnaz është e vërtetë se është i madh që maksimumi duhet të jetë 32 nxënës por presionet kanë ardhur prej juve dhe është rrit numri i nxënësve. Sa i përket konkursit që duhet të shpallet dy herë unë këtë nuk e kam parë në Ligj dhe kërkoj që të më ndihmon zyra ligjore. Mësimi zgjedhor është kopetencë e këshillit të shkollës dhe shkollës dhe lirisht po i them Enverit që të drejtohet atje. Kalueshmeria nuk bëhet me testin e arritëshmerisë por klasa e nëntë i nënshtrohet testit të arritshmërisë dhe caktohen poenat. Për Plitkoviq që u përmend e kemi siguru transportin meqë atje kemi vetëm 4 nxënës e gjithashtu kemi edhe shkolla tjera me pak nxënës siqë është Radeve. Te shpallja e konkursit e kam përfill udhëzimin administrativ, Ligjin e punës dhe kontratën kolektive.

U tha se informata është shumë e shkurtër është e vërtetë ka mund me qenë më e plotë ose më e detajizuar por kjo është informatë dhe nuk është raport. Te profesori

Xhevat që e tha për lëndën e astronomisë mund ta japin vetëm fizikantët na e kemi shpallur konkursin por nuk ka pasur kandidat me fizikë por vetëm me gjeografi. Te bartja e nxënësve me nevoja të veqanta ne kemi dy klasë që i bartin nxënësit në Lipjan dhe Magurë dhe kemi siguruar transportin për ta dhe kjo qështje duhet të adresohet në Drejtoratin për shëndetësi dhe zyra e Kryetarit që së paku t'ua paguajnë transportin. Te shkolla "Adem Gllavica" e dijë nevojën për sigurimin e fotokopjiuesve. Te kontrata kolektive ka kosto dhe kanë mbetë shujtja dhe transporti. Te tri pagat jubilarë për këtë vit ata që shkojnë në penzion e kemi problem me i siguru mjetet por për vitin e ardhshëm i kemi parapa me buxhet. Për shkollën në Kleçkë e kemi siguru ujin por e dijë se ka nevojë rregullimin e kulmit.

Xhevat Olluri, unë nuk e mora fjalën për me repliku me Drejtorin por unë shumë seriozisht po e konsideroj qështjen e astronomisë dhe janë 3 profesorë që japin fizikë aty dhe është mirë që atij që jep gjeografi dhe astronomi t'i ipen disa orë dhe ka mundësi që profesorëve të fizikës t'u ipen lëndët e astronomisë.

Florent Hoxha, unë po lidhem me performancën që e keni lëshu ju Drejtor për punën dhe suksistet që i ka arritë isht Drejtori Feti Buja të cilën performancë e keni nënshkru dhe në fund nuk e keni zgjedh Fetiun por Astrit Bujën i cili tani e ka marrë certifikatën.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni